



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr. 973/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca Dula, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, (KESco), me seli në Prishtinë Rr. “Bill Klinton”, nr.5, kundër debitorit N(N)Z nga fshati ..... , Komuna e Kaçanikut, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, PPP.nr.10/2019, të datës 28.01.2021, më datën 23.02.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit N(N)Z nga Komuna e Kaçanikut, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, PPP.nr.10/2019, i datës 28.01.2021, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: PRANOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit N(N)Z nga fshati ....., Komuna e Kaçanikut, SHFUQIZOHET (vihet jashtë fuqie) pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.131/18, i datës 19.12.2018, për periudhën nga data 07.03.2007 deri me datën 31.12.2011, në shumë prej 1.789,33 Euro, ashtu që propozimi për përmbarim i kreditorit për këtë shumë të borxhit REFUZOHET I PABAZUAR, ndërsa REFUZOHET i pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit N(N)Z, MBETET në fuqi pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.131/18, i datës 19.12.2018, për periudhën nga data 01.01.2012 deri me datën 20.03.2013, sa i përket shumës prej 122,10 Euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik me aktvendimin e atakuar PPP.nr.10/2019, të datës 28.01.2021, me pikën I të dispozitivit e ka refuzuar prapësimin e debitorit N(N)Z nga Komuna e Kaçanikut, i ushtruar me datë 26.12.2018, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat P.nr.131/18, i datës 19.12.2018, në tërësi si i pabazuar. Me pikën II të dispozitivit e ka detyruar debitorin ti paguajë shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë debitori për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (pretendime të kuptuara nga referati i ankesës), me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa e debitorit, ndërsa aktvendimi i atakuar të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyritim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, (KESco), me seli në Prishtinë Rr. “Bill Klinton”, nr.5, me datë 19.12.2018, ka paraqitur propozim për përbarim, ndaj debitorit N(N)Z nga fshati ..... Komuna e Kaçanikut, në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstraktit verifikuar nga librat afariste-kartelës së konsumatorit me DFE 129169, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori që kreditorit në emër të konsumit të energjisë elektrike për periudhën nga data 07.03.2007 e deri me datën 20.03.2013, t’ia paguajë shumën e përgjithshme të detyrimit prej 4.653.84 Euro.

Përbaruesi Privat Sh.L me seli në Ferizaj, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit ka lejuar përbarimin me urdhrin përbarimor P.nr.131/18, të datës 19.12.2018, duke vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet si dokument i besueshëm.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit debitori me datë 26.12.2018, ka paraqitur prapësim, duke theksuar se borxhi është parashkruar, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, ashtu që të anulohet në tërësi urdhri për lejimin e përbarimit dhe të detyrohet kreditori që ti bartë shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori me datë 09.01.2019, me të cilën ka theksuar se debitori ka bërë ka nënshkruar kontratën për dakordimin e borxhit dhe po ashtu ka bërë pagesa të kohë pas kohshme të borxhit të cilat kanë sjellë deri te ndërprerja e parshkrimit dhe pohimin e borxhit nga ana e debitorit.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.10/2019, të datës 28.01.2021, ka vendos që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.131/18, të datës 19.12.2018 dhe i njëjti urdhër ka mbetur në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se në prapësimin e debitorit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, e po ashtu debitori nuk ka ofruar prova ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së.

Ka shtuar se sa i përket pretendimeve për parashkrimin e borxhit, gjykata në kuptim të nenit 368 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, me rastin e pagesave të kohë pas kohshme e ka ndërprerë parashkrimin dhe rrjedhimisht edhe e ka pranuar borxhin. Andaj gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 77 paragrafi 1 dhe 5 të LPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, as në shkelje tjera të pretenduara, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 29 dhe 73 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, e në veçanti nuk e ka zbatuar fare dispozitën e nenit 360 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, që e rregullojnë institutin e parashkrimit, të cilin pala debitore e ka ngritur në prapësimin e tij.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e marrjes së aktvendimit të atakuar, por në mënyrë të gabuar e ka bërë zbatimin e të drejtës materiale, për çka edhe u dasht që aktvendimi i atakuar të ndryshohet. Në këtë konteskt Gjykata e Apelit vlerëson se me dispozitën e nenit 378 paragrafi 1, pika 1 të LMD-së, (Ligji i RSFJ-së, datës 30 Mars 1978), përcaktohet se: Parashkruhen për një vjet: “ Kërkesat e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit, për shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake ”.

Me nenin 387 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “ Pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit, por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kësteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit”.

Me nenin 388 të këtij ligji përcaktohet se: “ Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Me nenin 392 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Pas ndërprerjes së parashkrimit fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “ Parashkrimi i ndërprerë me anë të pohimit nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pohimi”.

Me nenin 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: “Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, ndërsa me paragrafin

2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.

Me nenin 368 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “ Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.

Me nenin 369 të LMD-së, të këtij ligji përcaktohet se: “ Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Me nenin 373 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Pas ndërprerjes së parashkrimit fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “ Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pranimi (pohimi)”.

Nga interpretimi dhe kuptimi i këtyre dispozitave Gjykata e Apelit vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për çka edhe ka vendosur që të njëjtin ta ndryshojë, duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.131/18, i datës 19.12.2018, dhe atë për periudhën nga data 07.03.2007 deri me datën 31.12.2011, në shumë prej 1.789,33 Euro, (*borxhi për këtë periudhë është në shumë 3.204,83 Euro, ndërsa pagesat brenda kësaj periudhë përfshinë shumën prej 1.415,50 Euro, totali i borxhit të mbetur përfshinë shumën 1.789,33 Euro*), ndërsa propozimin për përmbarim ta refuzojë si të pabazuar, pasi që borxhi për këtë periudhë është parashkruar në kuptim të dispozitave të lartcituara, prandaj referuar paragrafit 2 të nenit 360, në rastin konkret për kërkesën e kreditorit që ka të bëjë me vitin 2007, ka filluar të rrjedhë nga 01.01.2008 e deri me 31.12.2008, për kërkesat e vitit 2008, ka filluar të rrjedhë nga data 01.01.2009 deri me 31.12.2009, për kërkesat e vitit 2009, ka filluar të rrjedhë nga 01.01.2010 deri me 31.12.2010, për kërkesat e vitit 2010 afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga data 01.10.2011-31.12.2011, kurse propozimi për përmbarim është ushtruar me datën 19.12.2018, pasi që ka kaluar afati 1-vjeçar i parashkrimit të kërkesës së kreditorit, andaj është edhe vlerësim i gjykatës ankimore se me kalimin e afatit 1-vjeçar për kërkesat e shpenzimeve të energjisë elektrike, kreditori nuk mund të gëzojë mbrojtje juridike të së drejtës së tij pas kalimit të këtij afati.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket mënyrës së vendosjes si në pjesën e dytë të pikës I të dispozitivit të këtij aktvendimi që i referohet mbetjes në fuqi të pjesërishtëm të urdhrin për përmbarim P.nr.131/18, i datës 19.12.2018, për periudhën nga data 01.01.2012 deri me datën 20.03.2013, për shumën prej 122,10 Euro, Gjykata e Apelit një mënyrë të tillë të vendosjes e ka bazuar në dispozitën e nenit 360 paragrafi 2, 368 paragrafi 1 dhe 369 të LMD-së, pasi që në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës së kreditorit për faktin se me paraqitjen e propozimit për përmbarim të kreditorit me datë 19.12.2018, është ndërprerë afati i parashkrimit, për periudhën 01.01.2012 deri me datën 20.03.2013, konkretisht për shumën prej 122,10 Euro, (*borxhi për këtë periudhë është në shumë 752,10 Euro, ndërsa pagesat brenda kësaj periudhë përfshinë shumën prej 630,00 Euro, totali i borxhit të mbetur përfshinë shumën*

122,10 Euro) dhe rrjedhimisht edhe debitori është i obliguar që të përmbushë detyrimin e tij në këtë shumë. Ndërsa lidhur me pjesën tjetër të kërkesës së kreditorit para datës 18.01.2007, (që ka të bëjë me faturat nga data 2002-2007 të paraqitura në ekstrakt), Gjykata e Apelit nuk ka vendosur pasi që bazuar në dispozitën e nenit 2 të LPK-së, gjykata duhet të vendosë brenda kufijve të kërkesave të palëve të parashtruar nga pala ndërgjyqëse dhe meqenëse kreditori me propozim për përmbarim ka kërkuar vetëm borxhin për periudhën 18.01.2007-20.03.2013, prandaj edhe e njëjta ka vendosur vetëm për kërkesën e kreditorit brenda kësaj periudhe kohore.

Nga këto arsye, marrë për bazë pretendimin ankimor të palës ankuese rreth zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit, gjënë se në rastin konkret kemi parashkrim të pjesërishtëm të borxhit, andaj edhe për këtë arsyeja ka vendosur që aktvendimin e ankimuar të ndryshojë, të shfuqizohet pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit sa i përket shumës prej 1.789,33 Euro për periudhën nga data 07.03.2007 deri me datën 31.12.2011, dhe të refuzohet propozimi për përmbarim për këtë shumë, pasi që kërkesa është e parashkruar, ndërsa sa i përket borxhit për periudhën 01.01.2012 deri me datën 20.03.2013, në shumë prej 122,10 Euro, një kërkesë e tillë nuk është parashkruar, pasi që me paraqitjen e propozimit për përmbarim me datë 19.12.2018, është ndërprerë afati i parashkrimit, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në dispozitat e nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, që secila palë të bartë shpenzimet e saj të procedurës duke u bazuar në dispozitën e nenit 452.2 të LPK-së, pasi që e ka pasur parasysh suksesin e palëve në procedurën përmbarimore.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika c) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

Ac.nr.973/21, datë 23.02.2023

Gjyqtarja individuale:  
Nora Billaca Dula, d.v.